KËRKESË
Nr. 4918, datë 28.9.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën "Për shpronësimet për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "By-Pass Vlorë (shtesa)", për objekt dhe truall.

Subjekti kërkues i këtij objekti, është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, dtë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë" brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikun, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet për pasurinë e llojit objekt dhe truall. Pronarët do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik".

Vlera totale e shpronësimit është 9 832 636 (nëntë milionë e tetëqind e tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë.

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

Republika e Shqipërisë
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
Sektori i Shpronësimeve
Autoriteti Rrugor Shqiptar

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "BY PASS-VLORË (SHTESA)

Nr.	Pronari			Z. Kad	Nr. pasurisë	Sip. përgj	Truall	Objekt	Çmimi lekë/m²	Vlera totale në lekë	Konfirmimi
	Emri	Atësia	Mbiemri			m²	m²	m²			
1	B/P Haruni			8605	6/257	180	180		8300	1494000	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Bardhyl Haruni			8605	6/257/ND	149		149	55964	8338636	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
										9832636	